



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.123/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtar, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën koalicionit PDK-AAK-NISM më seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje(LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se njoftimit për tubimin elektoral në objektin publik për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e koalicionit PDK-AAK-NISM, kështu që subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,000.00 (dymijë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datën 07.06.2017 nga koalicionit PDK-AAK-NISM, me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017, ka vërejtur se në Rrugën “Qamil Bala” në lagjen Bregu i Diellit, hyrja 14, ishte vendosur materiale propaganduese zgjedhore si lajmë për mbajtjen e një tubimi elektoral posterat. Për këtë në kuptim të dispozitës së nenit 4.1 pikës (b) Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë publike përbën veprim të ndaluar për subjektin politik, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Me këtë rast koalicioni me vendosjen e postierit në drunj në një shesh publik ka bërë shkelje të dispozitave se nenit 4.1 pikës b) të rregullores Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullores Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur 2 (dy) fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, të datës 08.06.2017, thekson se kemi marrë masa përmirësues dhe kemi njoftuar shtabin zgjedhor të partisë, por të njëjtit na kanë sqaruar se banoret më vetiniciativë kanë vendosur njoftimet në hyrje të banesës dhe gjithashtu konsiderojmë se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, marrë parasysh vendin ku janë vendosur njoftimet nuk është në pronësi publike, të njëjtat janë në pronësi private, rrjedhimisht baza ligjore është në mospërputhje me ankesën. Rrjedhimisht nga ajo siç u cek me lartë konsiderojmë se duhet të hidhet poshtë si e palejuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se njoftimi për tubim nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, është vendosur në objektin publik e cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike”*

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstatoi se nga provat e ofertuar shihet qartë se nga ana e subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, është shkelur neni 33,pika b) të LPZ-së pasi që njoftimi për mbajtje të tubimit elektorral, janë vendosur ne objektin publik, në përgjigjen e ankesë të datës 07.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysht rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysht të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga subjekti politik LVV, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në objektin publik.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 08.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.123/2017 të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njëjës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administrative është parashikuar që *“Tërheqja e njëjës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim”*. Paneli nuk e bëri lejimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik LVV, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në

teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.123 /2017 më datën 09.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Rafet Haxhaj", is written over the printed name.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.